

KRITERET E PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAMIN E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE “BACHELOR” PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021 NË FAKULTETIN E VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT

- a. Kanë të drejtë të pranohen në programin e studimit të Ciklit të I Bachelor “Fushat e Vepimtarisë Fizike të Shëndetit dhe të Rekreacionit” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar sipas akteve nënligjore në fuqi.
- b. Kandidatët i nënshtrohen konkurimit praktik konform testeve të miratuara nga Senati i UST dhe të shpallura në faqen web të UST.
- c. Raporti ndërmjet konkurimit praktik dhe mesatares së kandidatit të jetë 70% me 30%. Për kandidatët që konkurojnë për të hyrë në Ciklin e I-rë Bachelor, duhet që të grumbullojnë minimum 12 (dymbëdhjetë) pikë nga 70 (shtatëdhjetë) të mundshme të konkurimit praktik.
- d. Kandidatët që konkurojnë në këtë program studimi, duhet të plotësojnë kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjeksore miratuar nga UST dhe e shpallur në faqen web të saj.